

## SKEMA E GRANTEVE 'ALTERNATIVE PATHWAYS' LOT 1

### Ndërgjegjësim dhe angazhim nëpërmjet medias për të ndikuar narrativat mbi emigracionin e paligjshëm

LOT 1 do të kontribuojë në Rezultatin e Programit: *Të rinj të ndryshëm angazhohen me median dhe komunitetet e tyre për të identifikuar problemet dhe çështjet, për t'u dhënë zë atyre dhe për të eksploruar zgjidhje të mundshme në nivel lokal.*

**Objektivi specifik** është rritja e bashkëpunimit dhe ndërtimi i besimit midis të rinjve dhe mediave lokale duke mundësuar angazhimin e mediave dhe gazetarëve lokalë, dhe ndërveprimin e tyre me të rinjtë, familjet dhe komunitetet e tyre, për të adresuar dhe advokuar së bashku për çështje dhe sfida lokale me interes për ta, për të krijuar përmbajtje multimediale dhe tregime relevante në nivel lokal, duke përfshirë rritjen e ndërgjegjësimin për rreziqet e emigrimit të paligjshëm.

#### Aktivitete të sugjeruara

Lista e mëposhtme jo shteruese e aktiviteteve do të konsiderohet si e pranueshme për këtë Thirrje. Një projekt propozim mund të përfshijë një ose më shumë nga sa vijon:

**A. Krijimi i përmbajtjes multimediale** me pjesëmarrjen e komuniteteve (fokus i veçantë tek të rinjtë), për adresuar disinformimin, kuptueshmërinë dhe perceptimet e gabuara për emigracionin e paligjshëm dhe pasojat/benefitet e tij.

*Temat që do të trajtohen mund të përfshijnë:*

- Emigracioni i paligjshëm, perceptimet publike, dezinformimi mbi çështje, fakte, të dhëna etj.
- Sfidat social-ekonomike të të rinjve dhe familjeve të tyre (duke përfshirë arsimin, punësimin, shëndetin, infrastrukturën, mjedisin, etj.)
- Ndikimi i emigracionit të paligjshëm në familje dhe komunitete
- Emigracioni i paligjshëm dhe trafikimi i qenieve njerëzore përmes lenteve gjinore (impakti)
- Histori njerëzore të jetës reale (modele të mira dhe dështime)
- Perspektiva për përfshirjen në tregun e punësimit
- Etj.

- B.** Mundësi për **ngritjen e kapaciteteve** për mediat lokale, gazetarët dhe punonjësit e tjerë të medias, profesionistët e lirë, blogerët, influencersit dhe aktivistët lokalë të angazhuar me krijimin e përmbajtjes multimediale (fokus i veçantë te të rinjtë, gratë dhe grupet e tjera vulnerabël), në keto drejtime:
- Zhvillim aftësish dhe njohurish në krijim dhe shpërndarje të prodhimeve multimediale për platforma të ndryshme mediatike e sociale
  - Si të nxitet ndërveprimi me komunitetet gjatë prodhimit të përmbajtjes gazetareske (fokus i veçantë te të rinjtë)
  - Verifikimi i fakteve dhe zbulimi i lajmeve të rreme
  - Përballja me dezinformata dhe perceptime të gabuara
  - Përdorimi i teknologjisë dhe AI në prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve mediatike dhe multimediale
  - Gazetaria e të dhënave dhe raportimi i bazuar në fakte dhe evidenca
  - Rritja dhe angazhimi i audiencës
  - Instrumenta dhe formate mediatike inovative
- C.** Ofrim mundësish **për programe internshipi** për të rinjtë që aspirojnë të punojnë në sektorin e medias, audio-vizualit, ose në departamentet e komunikimit të organizatave/kompanive
- D.** Nxitja e **ndërveprimit të gazetarëve lokalë me komunitetet**, aktivistët dhe shkollat:
- Forume diskutimi me përfaqësues nga media, shkolla, OJQ, aktivistë, pushteti lokal dhe biznesi lokal, mbi sfidat socio-ekonomike dhe zhvillimore me të cilat përballen
  - Fushata advokuese për çështje me interes të përbashkët publik
  - Aksion komunitar për çështje me interes publik (duke përfshirë nismat në komunitet, peticionet, raportim mediatik dhe advokim)
- E.** **Inisiativa lidhur me edukimin mbi median dhe informacionin (media literacy)** për të rinjtë, familjet e tyre dhe komunitetet

## **Kush mund të aplikojë**

### **Aplikantët e mundshëm mund të jenë:**

- Mediat lokale nga zona e veriut (jofitimprurëse dhe tregtare)
- Organizata të konsoliduara mediatike jo nga veriu, por në partneritet me të paktën një media/organizatë lokale ose grup joformal lokal nga zona e veriut
- Organizata lokale jofitimprurëse me përvojë në fushën e zhvillimit të medias
- Organizata jofitimprurëse të konsoliduara jo nga veriu, me përvojë në punë me media, por në partneritet me të paktën një media/organizatë lokale dhe/ose grup joformal nga rajoni
- Partneriteti lokal inkurajohet në të gjitha rastet

## **Buxheti**

Minimumi 10,000 GBP; Maksimumi 30,000 GBP

Varësisht nga numri i bashkive që do të mbulohen; tipologjia e aplikantit (kapaciteti zbatues) dhe shkalla e ndërhyrjes, buxheti mund të ndryshojë brenda intervalit të paracaktuar më sipër.

Lejohet nën-grantimi (si për organizatat më të vogla lokale ashtu edhe për individët).